



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 185 Prot.

Tiranë, më 24.01.2025

URDHËR

Nr. 18, datë 24.01.2025

PËR

MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR ORGANIZIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E RAUNDIT TË DYTË TË KONKURSEVE TË PRANIMIT NË
CIKLIN E III-TË, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22/7/2015 *Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24/1/2018 *Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*, i ndryshuar, Urdhrin e MAS Nr. 127, datë 16/3/2022 *Për Hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në "Arte Skenike"*, në Universitetin e Arteve të Tiranës, Urdhrin e MAS Nr. 128, datë 16/3/2022 *Për Hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në "Muzikologji"*, në Universitetin e Arteve të Tiranës, Urdhrin e MAS Nr. 668, datë 5/12/2023 *Për Hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në "Arte Pamore"*, në Universitetin e Arteve të Tiranës, Udhëzimin e MAS Nr.52, datë 03/12/2015 *Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë*, sikurse dhe pasi është konstatuar mosplotësimi i kuotave për programet e Ciklit të III-të në Universitetin e Arteve,

URDHËROJ:

Organizimi i raundit të dytë të konkurseve të pranimi për studime në ciklin e tretë, për fitimin e gradës shkencore "Doktor", në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve të zhvillohet si më poshtë vijon:

1. Në datën 27 Janar 2025 fakultetet pranë Universitetit të Arteve dorëzojnë në Rektorat kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimi në zbatim të urdhërit të Rektorit të UART dhe të rregulloreve përkatëse për programet e studimit të Ciklit III.
2. Në datën 3-4 Shkurt 2025 ora 08:00-16:00, kandidatët për konkursin e pranimi në Ciklin III për fitimin e gradës shkencore "Doktor" regjistrohen pranë sekretarive përkatëse në Universitetin e Arteve.
3. Në datat 6-7 Shkurt 2025 fakultetet e Universitetit të Arteve organizojnë zhvillimin e konkurseve të pranimi.

4. Në datën 10 Shkurt 2025 kryhet publikimi i listave të fituesve në fakultetet përkatëse dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.
5. Në datën 11 Shkurt 2025 kandidatët që nuk janë shpallur fitues mund të paraqesin ankimin drejtuar dekanit të fakultetit përkatës.
6. Në datën 12 Shkurt 2025 nga ora 08:00 deri në orën 16:00, në rast të mospasjes së ankimeve, kryhet regjistrimi i kandidatëve fitues pranë sekretarive mësimore të fakulteteve përkatëse të Universitetit të Arteve.
7. Në datën 14 Shkurt 2025 publikohen listat e kandidatëve të regjistruar.
8. Fakultetet mund të shpallin kandidatët fitues vetëm në përputhje me kuotat e deklaruar të paplotësuara dhe udhëheqësit shkencorë të paangazhuar sipas miratimit të MAS për vitin akademik 2024-2025.
9. Të afishohen në mjediset e secilit Fakultet të UART, Urdhërat/Vendimet mbi masat e marra për konkurset e pranimit, kriteret, procedurat dhe afatet e konkurseve të pranimit, si dhe çdo procedurë tjetër e nevojshme për këtë proces.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri të gjitha strukturat e UART të angazhuara në këtë proces.
11. Ky urdhër të shpallet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


REKTORI
Prof. Dr. Erald Bakalli